

Pershendetje zoti Matlija!

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 01/19, drejtuar Institucionit të Presidentit të Republikës, bashkelidhur do te gjeni:

1. Shkresën nr.Prot. 398, datë 15.11.2018, e Gjykatës Kushtetuese drejtuar Presidentit të Republikës, me listën e kandidatëve për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.
2. Shkresën nr. Prot. 3982 Prot, datë 13.11.2018, e Gjykatës së Lartë drejtuar Presidentit të Republikës, ku përcillet lista e kandidatëve për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.
3. Shkresën nr. 3054 Prot, datë 14.11.2018, e Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Presidentit të Republikës, me listën e kandidatëve për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.
4. Shkresën nr. Prot. 3479, datë 23.11.2018, të Institucionit të Presidentit të Republikës, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, mbi hedhjen e shortit për përzgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë.

Ju informojmë se për dokumentacionin e kërkuar, "kopje të CV -se për kandidatet e zgjedhur", mund t'u drejtoheni institucioneve respektive që kanë përcjellë kandidatët, apo Kuvendit të Shqipërisë.

Me respekt,

Margarita Hoxhalli
Koordinatorë për të Drejtën e Informimit
Institucioni i Presidentit të Republikës



PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Nr. 3389 Dt. 15.11.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

KRYETARI

Nr. Prot 398

Tiranë, më 15.11.2018

Lënda: Lista e Kandidateve për Keshillin e Emerimeve në Drejtësi.

Drejtuar: SH.T.Z. Ilir META
President i Republikës së Shqipërisë

I nderuar Z.President !

Në përmbushje të detyrimit që buron nga pika 3, e nenit 221, dhe te pikës 4 te nenit 284 të Ligjit nr 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, po ju paraqesim listën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që plotësojnë kushtet e parashikuara në Ligj, për të qenë Anëtarë të Keshillit të Emërimeve në Drejtësi,

- 1- Bashkim Dedja,
- 2- Vitore Tusha,

Me konsideratën më të lartë,

Kryetari





PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Nr. 335 Dt. 13.11.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 3982 Prot.

Tiranë, më 13/11/2018

Lënda: Dërgohet lista e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të cilët plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

SH.T.Z. ILIR META
PRESIDENT I REPUBLIKËS

Z. GRAMOZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT

TIRANË

I nderuar Z. President i Republikës,

I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,

Në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga pika 3 e nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Ju dërgojmë listën me emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të cilët sipas nenit 221 të këtij ligji, plotësojnë kriteret për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si vijon:

1. Z. Edmond Islamaj
2. Z. Ardian Dvorani
3. Z. Medi Bici

Gjithashtu, dëshiroj t’Ju informoj se gjyqtari **Ardian Dvorani** ka kandiduar për tu zgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese, ndërsa gjyqtari **Medi Bici** ka kandiduar për tu zgjedhur si anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
XHEZAIR ZAGANJORI
XHEZAIR ZAGANJORI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3054 Prot.

Tiranë, më 14. 11. 2018

Lënda: Për dërgimin e listës me emrat e prokurorëve që plotësojnë kushtet për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Drejtuar: **PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**
Z. ILIR META

KUVENDIT TË SHQIPËRISË
Z. GRAMAZ RUÇI

TIRANË

I nderuar z. President i Republikës,
I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Në përputhje me nenin 284 pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ju përcjellim bashkëlidhur listën me emrat e prokurorëve që plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Gjithashtu, po ju dërgojmë dhe listën me emrat e prokurorëve që i plotësojnë të gjitha kushtet e tjera, përveç kushtit për përfundimin e Shkollës së Magjistraturës.

Të dyja listat ju dërgohen me qëllim që institucioni ynë, për aq sa është e mundur, të jetë në koherencë të plotë me praktikën e institucioneve të tjera.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU



LISTA E PROKURORËVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI,


SIPAS NENIT 221, PIKA 1, TË LIGJIT 115/2016

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr.	Prokurorët	Në kohën e hedhjes së shortit magjistrati ka ushtruar funksionin për të paktën 10 vjet	Nuk ka një masë disiplinor e në fuqi	Nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit	Magjistrati ka përfunduar ciklin e plotë katër ose pesëvjeçar të studimeve në drejtësi	Magjistrati ka përfunduar Shkollën e Magjistraturë s	Magjistrati është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në 2 vlerësimet e fundit etik dhe profesional	Magjistrat i nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me sanksion administrati v për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesave	Shënime
1	Arta Marku	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	

PROKURORITË E APELEVE

1	Fajtona Memçaj	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	ANËTARE E KED
---	----------------	---	---	---	---	---	---	---	------------------



**LISTA E PROKURORËVE QË NUK I PLOTËSOJNË TË GJITHA KUSHTET PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË
DREJTËSI SIPAS NENIT 221, PIKA 1, TË LIGJIT 115/2016**

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr.	Prokurorët	Në kohën e hedhjes së shortit magjistrati ka ushtruar funksionin për të paktën 10 vjet	Nuk ka një masë disiplinore në fuqi	Nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit	Magjistrati ka përfunduar ciklin e plotë katër ose pesëvjeçar të studimeve në drejtësi	Magjistrati ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës	Magjistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etik dhe profesional	Magjistrati nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale	Magjistrati nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesave	Shënime
1	Adnand Kosova	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
2	Adnan Xholi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
3	Alfred Progonati	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
4	Alma Muça	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
5	Anila Leka	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	Kandidate për KLP

6	Arben Kraja	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	Kandidat për KLP	
7	Arqilea Koça	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
8	Artur Selmani	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
9	Bilbil Mete	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
10	Kostaq Beluri	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	Kandidat për KLP
11	Kujtim Luli	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
12	Petrit Fusha	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
13	Ramadan Troci	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	Kandidat për KLP
14	Sokol Stojani	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
15	Thoma Jano	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	

PROKURORITË E APELEVE

1	Artan Bajrami	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	Kandidat për KLP
2	Bujar Sheshi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3	Altin Dumani	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
4	Arben Qosja	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
5	Dritan Peka	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
6	Edmond Hyka	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

7	Genti Xholi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
8	Nezir Gjoka	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
9	Ferdinand Elezi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
10	Ludovik Dodaj	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
11	Moisi Duda	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
12	Altin Binaj	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
13	Henrik Haxhiraj	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
14	Kleanthi Zeka	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
15	Pelivan Malaj	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
16	Alfred Agolli	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
17	Gjon Fusha	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
18	Irma Balli	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
19	Rozeta Qirjaqi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
20	Arben Dollapaj	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	Kandidat për KLP
21	Brahim Dragjoshi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
22	Elvin Gokaj	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MÄRKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Nr.Prot. 3479

Tiranë, më 23.11 2018

Lënda: Mbi organizimin e shortit për përzgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2019.

Drejtuar: **Z. GRAMOZ RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Për dijeni: **SH.T.ZNJ. LEYLA MOSES-ONES**
E NGARKUAR ME PUNË E AMBASADËS SË SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

SH. T. Z. LUIGI SORECA
AMBASADOR I DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Institucioni i Presidentit të Republikës po ndjek me shqetësim të madh ecurinë e të gjitha proceseve të krijimit të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë. Ndryshimet kushtetuese u miratuan më 22 korrik 2016, duke parashikuar një periudhë tranzitore 8-mujore, brenda së cilës parashikohej të ngriheshin institucionet e reja, por tranzicioni ende nuk ka përfunduar edhe sot, kur kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 4 muaj nga miratimi i këtyre ndryshimeve. Aktualisht, prej disa muajsh vendi është në një situatë tepër shqetësuese për shkak të mosfunksionimit të institucioneve më të larta të dhënies së drejtësisë, si dhe të mos krijimit ende të institucioneve të reja të parashikuara nga legjislacioni i miratuar për reformimin rrënjësor të sistemit të drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese është praktikisht jashtë funksionit dhe nuk mund të marrë në shqyrtim asnjë çështje gjyqësore, sepse sot kjo gjykatë ka në përbërje të saj vetëm dy anëtarë nga nëntë gjithsej. Konkretisht Kryetari i kësaj gjykate z. Bashkim Dedja është konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ndërkohë që çështja e rivlerësimit kalimtar të këtij subjekti nuk është përmbyllur ende me vendim përfundimtar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA). Ndërsa znj. Vitore Tusha, është e vetmja që ka kaluar me sukses procesin e vetingut duke u konfirmuar në detyrë nga KPK me vendim të formës së prerë, por i ka përfunduar mandati 9-vjeçar si anëtarë

e Gjykatës Kushtetuese, që në muajin mars 2017 dhe në zbatim të nenit 125 pika 3 të Kushtetutës, ajo nuk ka të drejtë që të riemërohet në këtë pozicion. Ndërkohë që anëtari tjetër z. Gani Dizdari është shkarkuar nga detyra me vendim të KPK-së dhe ende nuk kanë përfunduar procedurat e shqyrtimit të ankimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

Gjykata e Lartë aktualisht funksionon vetëm me një trupë gjyqësore shumë të cunguar, me vetëm 4 gjyqtarë nga 19 gjithsej. Një pjesë e mirë e anëtarëve të saj (5 gjyqtarë) që kanë kaluar ose jo procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të Komisionin e Pavaur të Kualifikimit ndodhen në procedurë e sipër të shqyrtimit të ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ndërkohë siç raportohet publikisht pranë kësaj Gjykate, numri i çështjeve gjyqësore për t'u shqyrtuar ka arritur afërsisht 30 mijë.

Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dy organet kryesore të qeverisjes së sistemit të drejtësisë nuk janë krijuar ende, pasi nuk kanë përfunduar të gjitha procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë në këto këshilla.

Ndërkohë që, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi një organ ky i zgjedhur me shortin e organizuar nga Kuvendi të datës 07 dhjetor 2017, rezulton se nuk ka funksionuar ashtu siç duhet përgjatë gjithë vitit 2018. Ky këshill rezulton të jetë mbledhur vetëm një herë më datë 19 mars 2018, mbledhje kjo e zhvilluar me kërkesë të Presidentit të Republikës dhe ku kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e tij. Më pas përgjatë gjithë vitit 2018, rezulton se KED nuk është mbledhur më. Në këtë mënyrë procesi i verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, për plotësimin e dy vakancave të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe për vakancat e tjera të shpallura nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Gjykata e Lartë, ka ngelur pezull dhe nuk është kryer nga KED-ja aktuale.

Gjithashtu, Presidenti i Republikës në cilësinë e organit të emërtesës me Dekretin nr.10946, datë 09.11.2018, ka shpallur procedurën e aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese edhe për plotësimin edhe të vakancës tjetër të krijuar rishtazi nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtares znj. Altina Xhoxhaj, shkarkuar me vendimin nr.9, datë 24.10.2018, të KPA-së.

Presidenti i Republikës në mënyrë të përsëritur zyrtarisht me shkresë dhe publikisht ka kërkuar mbledhjen e KED-së për shqyrtimin e kandidaturave të paraqitura për vakancat e krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe plotësimin e kësaj gjykate më anëtarët e saj. Megjithatë, siç dhe jeni në dijeni, deri më sot ky proces nuk është kryer. Për më tepër nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë shpjegim serioz dhe objektiv mbi këtë çështje nga asnjë institucion shtetëror, apo mision ndërkombëtar që asiston institucionet shqiptare për implementimin e reformës në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu referuar kërkesave të Kushtetutës dhe ligjit nr.115/2016, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i zgjedhur me shortin e organizuar nga Kuvendi më datë 7 dhjetor 2017, ka gëzuar kuorumin e nevojshëm të funksionimit dhe të vendimmarrjes që prej datës 1 janar 2018 deri më datë 08.10.2018.

Në këto kushte, tashmë kemi ardhur në fund të vitit 2018, ku KED aktuale është drejt përfundimit të mandatit të saj 1-vjeçar dhe për më tepër, që prej datës 8 tetor 2018, nuk ka as kuorumin e nevojshëm për tu mbledhur dhe për të marrë vendime. Ndërkohë sipas afateve të përcaktuara në

Kushtetutë dhe në ligjin nr.115/2016, është e nevojshme ndërmarrja e veprimeve për përzgjedhjen e KED-së, së re, që do të funksionojë për vitin kalendarik 2019.

Aktualisht, rezulton se situata ligjore në lidhje me përzgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nuk ka ndryshuar. Sipas nenit 149/d të Kushtetutës, Këshilli Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë, të përzgjedhur me short nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë nga gjykatat e apelit, dy prokurorë nga gjykatat e apelit, një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Kriteria të tjera për shkallën e kualifikimit të kandidatëve që marrin pjesë në short parashikohen me ligj.

Ndërkohë kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimit në Drejtësi dhe procedurat e përzgjedhjes janë parashikuar në Kreun II, neni 221 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë". Në këtë dispozitë ndër të tjera parashikohet se: "**3. Jo më vonë se data 15 nëntor e çdo viti kalendarik, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë verifikojnë nëse kandidatët për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dhe i paraqesin Presidentit të Republikës dhe Kuvendit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet.**"

Pra në kushtet aktuale gjendemi në të njëjtën situatë, si në muajin nëntor të vitit 2017, ku për shkak të moskrijimit të institucioneve të reja të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, institucionet e ngarkuara për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së (Presidenti dhe Kuvendi), gjenden përpara një situatë ekstra ligjore. **Kjo sepse në mungesë të krijimit të KLGJ-së dhe KLP-së sërish edhe për këtë vit, i vetmi institucion që mbart detyrimin sipas nenit 221, pika 3 të ligjit nr.115/2016, për të përcjellë listën e kandidatëve për tu zgjedhur si anëtarë të KED ngelet vetëm Gjykata Kushtetuese. Ndërkohë që, nuk ka asnjë parashikim tjetër ligjor apo kushtetues, se kush institucion tjetër mandatohet sipas ligjit që të kryejë funksionin e KLGJ-së dhe KLP-së, në rast të moskrijimit të tyre.**

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, në përmbushje të afatit të prashikuar në nenin 221 pika 3, të ligjit nr.115/2016, me shkresë nr.398 prot., datë 15.11.2018, ka përcjellë në adresë të Presidentit listën e dy gjyqtarëve të vetëm të kësaj gjykate që sipas vlerësimit të tij plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj, për të qënë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (z. *Bashkim Dedja dhe znj. Vitore Tusha*). Në ndryshim nga viti i kaluar situata faktike në këtë moment vështirësohet edhe më shumë në kushtet kur Gjykata Kushtetuese paraqet vetëm dy anëtarët aktualë të kësaj Gjykate. Siç e përmendëm më sipër, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese z. Bashkim Dedja, ndodhet ende në proces e sipër të rivlerësimit kalimtar, pasi vendimi i dhënë nga KPK për konfirmimin e tij në detyrë është ankimuar dhe pret shqyrtimin në Kolegjin e Apelimit. Ndërkohë emri tjetër i përcjellë është ai i znj. Vitore Tusha, për të cilën kanë përfunduar procedurat e vetingut me

vendim të formës së prerë, por që në fakt asaj i ka përfunduar mandati 9-vjeçar i qëndrimit në detyrë që prej datës 10 mars 2017, fakt ky i deklaruar sipas ligjit me vendimin nr.19, datë 10.03.2017, të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu në zbatim të nenit 125 pika 3 të kushtetutës znj.Tusha nuk i lejohet riemërimi në këtë pozicion. Për më tepër, me vullnetin e saj, pas shpalljes së procedurave të aplikimit, znj. Vitore Tusha ka shprehur interesin dhe ka paraqitur kërkesën për tu përzgjedhur në pozicionin kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kandidatura e znj. Vitore Tusha për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit i është propozuar Kuvendit për tu zgjedhur në këtë pozicion me dekretin nr.10929, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës. Paraqitja e kërkesës prej saj është shprehje e qartë e vullnetit për të mos vazhduar më detyrën e anëtarit të kësaj Gjykate në rast të zgjedhjes së saj nga Kuvendi si Kryetare e KLSH-së.

Ndërkohë në mungesë të propozimeve të listave që duhet të paraqiteshin nga KLGJ dhe KLP, organe këto të pa krijuara ende, konstatohet se edhe pse nuk ka patur ndonjë kërkesë zyrtare nga Institucioni i Presidentit të Republikës, në adresë të tij, por dhe të Kuvendit të Shqipërisë institucionet e Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm respektivisht me shkresat nr. 3982 prot., datë 13.11.2018 dhe nr. 3054 prot., datë 14.11.2018, kanë përcjellë listat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe listat e Prokurorëve që sipas vlerësimit të tyre plotësojnë kushtet dhe kriteret për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Gjykata e Lartë nëpërmjet shkresës nr. 3982 prot., datë 13.11.2018, ka dërguar pranë Institucionit të Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë listën e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të cilët plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të KED. Sipas kësaj shkrese plotësojnë kriteret për tu zgjedhur anëtarët Edmond Islamaj, Ardian Dvorani, Medi Bici. Vihet re se nuk është përfshirë në këtë listë emri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë z. Xhezair Zaganjori. Ndër të tjera Gjykata e Lartë informon me shkresën e mësipërme se gjyqtari Ardian Dvorani ka kandiduar për tu zgjedhur si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, ndërsa gjyqtari Medi Bici ka kandiduar për tu zgjedhur si anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 3054 prot., datë 14.11.2018, ka përcjellë dy lista me kandidatë që sipas këtij institucioni plotësojnë kushtet për tu zgjedhur si anëtarë të KED. Një listë me emrat e Prokurorëve që plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ku përfshihen vetëm emrat e Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme znj. Arta Marku dhe znj. Fatjona Memçaj, Prokurore nga Prokuroria e Apelit (*aktualisht anëtare e KED-së*), si dhe një listë tjetër me emrat e 37 Prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të Apeleve, të cilët sipas Prokurorisë së Përgjithshme plotësojnë të gjitha kushtet e tjera, përveç kushtit të përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, kusht ky i parashikuar për tu plotësuar sipas nenit 221, pika 1/d të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë".

Sekretari i Përgjithshëm i KLD-së, me shkresë nr.3285 prot, datë 15.11.2018, konfirmon se, në vlerësim të interesimit të Kuvendit mbi këtë çështje, në zbatim të nenit 221 të ligjit nr.115/2016, Sekretari i Përgjithshëm i KLD-së, nuk parashikohet si institucion që mbart detyrim e drejtëpërdrejtë sipas ligjit për të dërguar ndonjë listë brenda afatit 15 nëntor për zgjedhjen e KED-së, pasi sipas këtij neni kjo detyrë është në kompetencë të organeve të reja të KLGJ-së dhe KLP-

së, organe këto që nuk janë krijuar ende. Sekretari i Përgjithshëm i KLD-së, konfirmon në këtë shkresë se nëse nga institucioni i Presidenti të Republikës apo Kuvendit të Shqipërisë, do të vleresohet aplikimi edhe për këtë vit i dispozitave tranzitore të parashikuara në nenin 284 të ligjit nr.115/2016, atëherë kërkesa për informacion e institucionit që do të organizojë shortin do të trajtohet menjëherë në përputhje me kushtetutën dhe ligjin. Në këtë shkresë është evidentuar praktika shkresore e mëparshme e mbajtur me Kuvendin përpara procesit të hedhjes së shortit të datës 07.12.2017 për zgjedhjen e KED-së aktuale.

Në këto kushte, konstatohet se, pyetjes së ngritur vitin e kaluar në muajin nëntor 2017, nëse do të përdoren sërish dispozitat tranzitore të parashikuara në nenin 284, të ligjit nr.115/2016, që në mungesë të KLGJ dhe KLP, shorti mund të mund të hidhet sërish bazuar në kandidaturat e përcjella nga Prokurori Përgjithshëm, Kryetari Gjykatës së Lartë, Sekretari i Përgjithshëm i KLD-së, Kuvendi nuk i ka dhënë një zgjidhje nëpërmjet ndryshimeve ligjore për rregullimin e kësaj situate.

Kuvendi rezulton se gjatë hedhjes së shortit në 7 dhjetor 2017, nëpërmjet intepretimit ka përdorur dispozitat tranzitore të nenit 284 të ligjit nr.115/2016, por duke zgjedhur organin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pikërisht mungesa e parashikimit ligjor për zgjidhjen e një situate të tillë, dhe precedenti i krijuar nga Kuvendi në shortin e hedhur në 7 dhjetor 2017, duket se ka qenë dhe arsyeja që disa prej institucioneve, kanë përcjellë këtë vit me iniciativë brenda datës 15 nëntor 2018, listat e kandidatëve të tyre, edhe pse ligjërisht ata nuk e mbartin këtë detyrim të drejtëpëdrejtë nga ligji.

Në kushtet e kësaj situate faktike dhe pa asnjë ndryshim në parashikimet e ligjit, procesi i përzgjedhjes së KED-së së re që do të funksionojë përgjatë vitit 2019, duket se i vendos organet e ngarkuara për realizimin e tij përpara një vendimarrje ekstra ligjore, gjë e cila krijon terren që procesi i përzgjedhjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të bëhet objekt diskutimi.

Në zbatim të nenit 94 të Kushtetutës dhe duke vlerësuar në mënyrë të përgjegjshme situatën aktuale, Presidenti i Republikës çmon se, dispozitat e ligjit nr.115/2016, nuk janë sërish të plota për të rregulluar situatën e krijuar nga mungesa e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Presidenti i Republikës, gjendet sërish përballë një situate, jo të pastër ligjore, në të cilën ky institucion nuk mund të ushtrojë kompetencat e tij kushtetuese të parashikuara në nenin 149/d të Kushtetutës, pasi për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Presidenti nuk mund të bazohet në kandidatura të propozuara nga një proces "ekstra ligjor" nëpërmjet interpretimit dhe të diskutueshëm. Për më tepër, institucionet të ndryshme kushtetuese duket qartësisht se interpretojnë rregullat procedurale dhe kriteret e kandidatëve për tu zgjedhur në KED në mënyrë të ndryshme dhe jo uniforme.

Duke vlerësuar rrethanat e faktit ku precedenti i krijuar mbi këtë çështje është aplikuar dhe krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës vlerëson se edhe për këtë vit Kuvendi është i vetmi organ që ka mundësinë dhe detyrimin për ta zgjedhur këtë situatë.

Kuvendi i Shqipërisë, është organi i vetëm që e ka mundësinë e rishikimit të dispozitave të ligjit apo të një interpretimi autentik, duke qenë se, së pari është autor i miratimit të tyre, dhe së dyti, është organi që me praktikën e ndjekur deri më tani, ka krijuar dhe precedentin mbi këtë çështje.

Presidenti i Republikës, vlerëson gjithashtu se, Kuvendi duhet të analizojë në mënyrë të kujdesshme këtë proces, për të siguruar njëkohësisht jo vetëm përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së së re, por duhet të sigurojë njëkohësisht dhe vazhdimësinë dhe funksionalitetin e këtij organi përgjatë gjithë vitit 2019. Mbi këtë çështje, Presidenti i Republikës me shkresë nr.1464/1 prot, dt 16 korrik 2018, i ka rekomanduar Kuvendit marrjen e masave që nëpërmjet procesit legjislativ të zgjidhë çdo situatë problematike.

Kuvendi i ka të gjitha mundësitë për të ndërmarrë nismën për ndërhyrje legislative me qëllim rregullimin e dispozitave që kanë shfaqur problematikë gjatë zbatimit në praktikë, për të siguruar zgjidhjen e çdo situatë, në mënyrë që KED të jetë funksionale për të ushtruar përgjegjësitë e saj, për të vlerësuar dhe renditur kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Me përgjegjësinë e lartë dhe me vullnetin e mirë për të mos humbur kohë, Presidenti i Republikës vlerëson se i takon Kuvendit të Shqipërisë, si institucion ligjberës në Shqipëri, të realizojë procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në frymën e Kushtetutës.

Presidenti i Republikës, në cilësinë e Kreut të Shtetit, dhe njëkohësisht si Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, garanton dhe i ofron Kuvendit të Shqipërisë, të gjithë mbështetjen e nevojshme me qëllim zgjidhjen e kësaj situatë të krijuar dhe kapërcimin e saj.

Bashkëlidhur po ju përcjell aktet e dërguara nga institucionet e sipërcituara.

